



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.508/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arafat Basha, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Kamenicë, nga radhët e subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Arafat Basha, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Kamenicë, nga radhët e subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, me shenjen ZL.Anr.508/2017 të datës 25.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017,

A r s y e t i m

Më datën 24.10.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Arafat Basha, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal të Kamenicë, nga radhët e subjektit politik LDK, me të cilën pretendon se ka pasur keqpërdorim të votave në Qendrat e Votimit në Komunën e Kamenicës, si në vendvotimet: Koretinë 1024D/01R, 1024D/02R dhe 1024D/03R.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesat e parashtruara përkitazi me manipulimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesa, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrihen pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, është marrë vendimi përfundimtar, mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj paneli vendosi që ta hudh si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, që të paraqes ankesë tjetër, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.508/2017 më datën 25.10.2017.

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*